



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 414/2 Prot.

Pogradec, më 16 09 .2021

VENDIM

NR. 78 , DATË 14. 09 .2021

**PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES, PREJ 2, 537 (DY PRESJE PESEQIND E
TRIDHJETE E SHTATE) HA, QË SHTRIHEN NË EKONOMITË
PYJORE/KULLOSORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE UJI I FTOHTË), DHE
EKONOMIA KULLOSORE GURI I TOP – GJEMTH, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE "ZGALLO 1", "ZGALLO 2", NGA SHOQERIA
"AUTOVISION AL" SHPK**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pikën 4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Per sektorin e energjitikes", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", neni 20 dhe neni 23 të Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 1064, datë 22.12.2010, pikës 22 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor publik", Urdhërit Nr. 340, datë 17.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Pogradec "Per hartimin e studimit tekniko-ekonomik" si dhe referuar "Miratimit paraprak" i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 14124/2, datë 18.12.2018 "Për vazhdimin e procedurave për ndertimin e burimit të ri gjenerus të energjisë, hidrocentraleve "ZGALLO 1", "ZGALLO 2", në rrjedhjen e siperme te Lumit Shkumbin, ne deget anesore te tij perkatesisht ne perroin e Gurit dhe degeve te tij dhe perroin e Zgallos, bashkia Pogradec, Qarku Korce", duke marrë në konsideratë detyrimet ligjore që për Hidrocentralet janë me kapacitet 760 kW (poshtë 2 MW) të cilët miratohen me Lejën e Ministrit si dhe duke qënë që shoqëria "AUTOVISION AL" SHPK, sipas miratimit paraprak gëzon të të drejtën ekskluzive, per te bere matje ose studime te tjera lidhur ne investimet per ndertimin e hidrocentraleve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë, dhënien në përdorim të sipërfaqes prej **2,537** (Dy presje peseqind e tridhjetë e shtate) Ha, që shtrihen në Ekonomia pyjore/kullosore Bishnicë (Pjesa ekonomike Uji i Ftohtë), dhe Ekonomia kullosore Guri i Top – Gjemth, sipas studimit tekniko-ekonomik të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, formularit Nr.1, dhe planvendosjes së objekteve të HEC, të dorëzuar nga shoqëria "AUTOVISION AL" shpk, për ndërtimin e hidrocentraleve "Zgallo 1", "Zgallo 2", me kapacitet deri ne 760 KW, sipas dokumentacionit bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërse të tij.
2. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë deri në 10 (Dhjetë) vjet, me të drejtë ripërtëritje, sipas afatit të lejës/kontratës koncensionare.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë përpara një noteri publik, sipas tekstit bashkëngjitur, pjesë përbërse e këtij vendimi dhe shoqëruar me kartelat e pasurive të përditësuara, pa kufizime.
4. Shoqëria "AUTOVISION AL" shpk, të kryejë aktivitetin në sipërfaqet e miratuara vetëm mbas nënshkrimit të kontratës, dorëzimit të siperfaqes sipas pikes 1, me procesverbal dorëzimi dhe vetem mbasi te jete kryer pagesa per vitin e parë.
5. Procesverbali i dorëzimit të sipërfaqes sipas pikës 1, të hartohet vetëm pasi shoqëria "AUTOVISION AL" shpk të ketë nënshkruar kontratën përkatëse me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku të jenë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet mbi realizimin e këtij projekti.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

